

**MARRËVESHJE TRANSFERIMI TË PJESËVE TË KAPITALIT
TË SHOQËRISË
EL&EL CONSTRUCTION SH.P.K**

Në Tiranë, sot më 07 / 10 / 2025, palët e kësaj Marrëveshjeje ranë dakort si më poshtë:

Znj. Elda Betaj, atesia Mentor, amesia Diana, shtetase shqiptare e lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, me adresë rr. "Tish Daija", ndertesa nr. 1, hyrja nr. 13, apartamenti nr. 13, njesia administrative nr. 5, njesia bashkiake nr. 5, 1019, Tiranë, Shqipëri, gjendja civile "e martuar", mbajtese e leternjoftimit me nr. 035116408 dhe nr. J15614078O, madhore me zotesi të plote juridike për të vepruar;

(më poshtë referuar "SHITËSI")

GJOKA-AL NDERTIM Sh.p.k, shoqëri e së drejte shqiptare, me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar rregullisht në regjistrin tregtar në Qendren Kombëtare të Biznesit në datë 07.01.2016 i pajisur me NUIS L61307018T me seli në adresën Rruga e Durrësit, zona e ish fushës së aviacionit, zona kadastrale 8210, apartamenti Kulla A Nr. 9/07-a e përfaqësuar nga administrator **Z. Artan Gjoka**, shtetas shqiptar, atesia Ramazan, amesia Hasime lindur me 04.04.1985 në Ternovë e Madhe, Diber dhe banues në Tiranë, Shqipëri në adresën rruga "Andrea Kushi", ndertesa nr. 25, hyrja nr. 1, njesia administrative nr. 7; 1023, Tiranë, mbajtes i leternjoftimit elektronik ID me nr. 038706130 dhe nr. Personal I50410011V, madhor me zotesi të plote juridike për të vepruar;

(më poshtë referuar "BLERËSI")

Z. Shkëlzen Betaj, shtetas shqiptar, lindur më 12/06/1985, në Tiranë, madhor e me zotesi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i Dokumentit të Identifikimit me Nr. personal I50612055F, madhor me zotesi të plote juridike për të vepruar

(më poshtë referuar "DHËNËS PELQIMI")

MEQËNËSE:

- A. Shitësi zotëron 50% të Kapitalit të Shoqërisë "**EL&EL Construction**" Sh.p.k, një shoqëri ekzistuese sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar me NIPT **M51824031I**, me seli në: Rruga Hysni Gerbolli, Pallati Ultratech, Shkalla C, kati nr. 2, apartamenti nr. 55, Zona kadastrale 8310, Tiranë, Shqipëri ("**Shoqëria**"), me një kapital prej 100.000,00 (njëqind mijë) Leke.
- B. Blerësi dëshiron të blejë 50 % të Kapitalit të Shoqërisë të zotëruar nga Shitësi në Shoqërinë e lartpërmendur "**EL&EL Construction**" Sh.p.k siç përcaktohet në këtë marrëveshje.



- C. Në përputhje me **Ligjin Nr. 9901**, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar dhe nenet e Statutit të Shoqërisë, Ortaket kane marrë vendimin përkatës për transferimin tek Blerësi **shoqeria GJOKA-AL NDERTIM Shpk**, të 50 % të kapitalit si më sipër.
- D. Më tej Blerësi ka disponuar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë lidhur me blerjen që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë “**EL&EL Construction**” **Sh.p.k.**, në pronësi të shitëses (ortakes) Elda Betaj.
- E. Znj. Elda Betaj ka lidhur martese ligjore me Z. Shkëlzen Betaj dhe në kuptim të neneve 74-77 të Kodit të Familjes të Republikës së Shqipërisë ky i fundit është pjesë e kësaj kontrate transferimi të pjesëve të kapitalit në cilësinë e Dhënësit të Pëlqimit.

PER SA ME SIPER, palët bien dakort si më poshtë:

1. Shitësi pranon se ka marrë nga Blerësi në mënyrë të plotë të gjithë çmimin e blerjes të rënë dakord në vlerën prej 5,000 EUR (*pese mije*) EUR dhe për këtë arsye transferon ketu 50 % të Kapitalit të zotëruar nga Shitësi **Znj. Elda Betaj** tek Blerësi **shoqeria GJOKA-AL NDERTIM Sh.p.k**
2. Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se përbën 50% (pesedhjetë përqind) e kapitalit themeltar që transferohet këtu është në pronësinë e tij të plotë ligjore dhe të lirë nga barra, hipoteke apo pengje.
3. Blerësi pranon pronësinë e 50% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, duke njohur gjendjen e Shoqërisë dhe bien dakord me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lindura nga zotërimi i 50% të kapitalit brenda Shoqërisë, sipas përcaktimeve të Statutit të Shoqërisë dhe ligjit shqiptar.
4. Me nënshkrimin e kësaj kontrate për transferimin e pjesëve të kapitalit, ortakë të shoqërisë dhe pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre në shoqërinë “**EL&EL Construction**” **Sh.p.k** do të jetë:
 - **GJOKA-AL NDERTIM Sh.p.k.**, - zotëron 1 kuote me 50% të kapitalit të shoqërisë.
5. Shitësi dhe Blerësi bien dakord të zbatojnë dhe të paraqesin që në kërkesën e parë të palës tjetër të gjitha dokumentet e nevojshme në mënyrë që të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e transferimit që perben 50% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, objekt të kësaj kontrate, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit si dhe në çdo autoritet tjetër sipas përcaktimeve të Ligjit Shqiptar.
6. **Z. Shkëlzen Betaj** në cilësinë e bashkeshortit të Shitëses, Znj. Elda Betaj, ortakë në shoqërinë **EL&EL Construction**” **Sh.p.k** zotëruese e 50% të kapitalit të Shoqërisë,



për efekt të martesës deklarohet se është dakord që 50 % të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, objekt i kësaj kontrate për transferimin e pjesëve të kapitalit, në pronësi të bashkëshortes së tij të transferohet përmes shitjes tek Bleresi.

7. Dhënësi i pelqimit Z. Shkëlzen Betaj deklarohet se nuk ka asnjë pretendim lidhur me këtë vendimarrje të bashkëshortes së tij për shitjen e 50% të kapitalit të regjistruar që zotëron tek Shoqëria dhe nuk do ketë asnjë pretendim në të ardhmen lidhur me këtë shitje.

Kjo Marrëveshje u hartua në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe, me vlerë të barabartë ligjore.

Marrëveshja bazohet në nenin 705 të Kodit Civil (Shqiptar) dhe në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar. Marrëveshja u lexua nga palët, u gjend e rregullt, në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe u nënshkrua rregullisht prej tyre.

PALET

SHITESI

Elda Betaj

Elda Betaj

(emri, mbiemri, nënshkrimi)

BLERESI

GJOKA-AL NDERTIM Sh.p.k

Perfaqesuar nga administratori

Artan Gjoka

Artan Gjoka

(emri, mbiemri, nënshkrimi, vula)



DHENESI I PELQIMIT

Shkëlzen Betaj

Shkëlzen Betaj

(emri, mbiemri, nënshkrimi)

Sen